Komuna, për të bashkëpunuar me fshatrat dhe vendbanimet me vendim të veçantë të kuvendit të komunës mundë të përcaktojnë formën e bashkëpunimit, strukturën organizative dhe funksionale, mënyrën, kohën dhe çështjet tjera që lidhen me zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane.

PJESA IV

KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 17

17.1 Komuna duhet të konsultoj publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte dhe se janë marrë parasysh edhe përvojat e qytetarëve, janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit si dhe implementimi i të gjitha vendimeve të propozuara është bërë në mënyrë efektive në praktikë.

17.2 Komuna gjithashtu duhet të sigurojë që qytetarët kanë pasur mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat e kërkesat e tyre janë marrë në shqyrtim.

Neni 18

Komuna mund të shfrytëzojë secilën nga format e konsultimit të shënuar më poshtë si dhe forma të tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave.

1. Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale,
2. Kontakte me grupet e fokusit për ti testuar dhe diskutuar politikën,
3. Anketat për implementimin e politikës, përfshirë përveç të tjerave informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo,
4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft rregulloret duke thirrur për pjesëmarrje në prezantime,
5. Kontakte me grupet e interesit dhe mbledhjet me grupet e interesit
6. Komitetet këshillëdhënëse të qytetarëve
7. Takimet publike,
8. Dëgjimet publike,
9. Studimet për vlerësim të efektit dhe
10. Peticionet

Neni 19

Kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit, komitetet e kuvendit dhe drejtorët e drejtorive komunale do të kenë autoritetin të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që janë në kompetencat e tyre.

Neni 20

Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

21.1 Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qartë dhe duhet të përfshijnë informatat e nevojshme për ti lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje që nuk do të paraqet vështirësi për grupet fokusuese, konsultuese dhe grupet tjera për të shpreh mendimet, përgjigjet apo vërejtjet e tyre.

21.2 Kur përcaktohen grupet e fokusit në procesin e konsultimeve, komuna duhet të sigurojë që palët relevante kanë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

Neni 22

Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe duhet t'i adaptojë kanalet komunikuese, në mënyrë që t'i përmbush synimet e audiencës. Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.

Neni 23

Komuna duhet të lejojë kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet ti lejojë së paku 4 javë për marrjen e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut.

Neni 24

Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke ju kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.

KAPITULLI II

TUBIMET ME PUBLIKUN

Neni 25

25.1 Tubimet me publikun duhet të mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe një në gjashtëmujorin e dytë.

29.3 e takimit e tina publike përfaqësuesit e komunës informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mundë të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

Neni 26

26.1 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimeve publike duhet të shpallen së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Takimet publike do të mbahen kryesisht në kohë të përshtatshme për pjesëmarrjen e publikut apo komunitetit të caktuar.

26.2 Përfaqësuesit e mjeteve të informimit kanë të drejtë pjesëmarrje në çdo mbledhje publike.

Neni 27

27.1 Kryetari apo përfaqësuesit e tij duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai duhet ta ketë autoritetin ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes si dhe ka autoritetin të mos lejojë diskutimin për disa çështje të caktuara që nuk janë të lidhura me çështjen e diskutuar apo që nuk janë në kuadër të kompetencave të pushtetit të komunës ose edhe nuk kanë të bëjnë me punët e komunës.

27.2 Ai apo përfaqësuesi i tij që kryeson mbledhjen me publikun mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

Neni 28

Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh pas ditës së takimit.

Neni 29

Procesverbalet e secilit takim publik duhet të ruhen me të gjitha informatat e hollësishme që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e publikut dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra . Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të më vonshme duhet ti bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

Neni 30

Komiteti për politikë dhe financa duhet ta shqyrtojë procesverbalin e mbledhjes publike brenda 60 ditëve pas mbledhjes. Komiteti duhet të shqyrtojë secilin propozim të

KOMITETET KONSULTATIVE

Neni 31

Kuvendi komunal duhet të krijojë komitetet konsultative sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendim-marrës. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, kuvendi komunal duhet të sigurojë një përfaqësim të gjerë nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, në krijimin e këtyre komiteteve, duhet të merret parasysh balancën gjinor dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese apo fshatrave brenda komunës.

Neni 32

32.1 Komitetet konsultative duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës. Ata gjithashtu duhet të monitorojnë ofrimin e shërbimeve në sektorët relevant dhe të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjedhjen e problemeve të identifikuar. Në kryerjen e detyrave të tyre komitetet konsultative duhet të punojnë së bashku me komitetet e kuvendit në mënyrë të tillë që, vendimet e komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit plenar duhet të merren vetëm pas konsultimit me komitetin konsultativ sektorial.

32.2 Komitetet konsultative duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës.

32.3 Komitete konsultative gjithashtu mundë të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjedhjen e problemeve të identifikuar.

Neni 33

33.1 Anëtarët e komiteteve konsultative duhet të emërohen me mandat 3 vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohen çdo vit . Përbërja e këtyre komiteteve duhet te ketë përfaqësimin gjinor. Asnjë anëtar i komitetit konsultativ nuk mund të shërbejë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

33.2 Shkarkimi i anëtarëve të komiteteve konsultative bëhet nga Kuvendi i Komunës pas propozimit të bërë nga kryetari i komunës për shkak të sjelljeve të këqija dhe shkeljeve të rregulloreve lokale dhe ligjit në fuqi.

PJESA V

KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI I KUVENDIT DHE
KOMITETET E TIJ

Neni 38

38.1 Kuvendi i komunës formon komitetet e përhershme dhe komitetet Këshillëdhënëse për të cilët konsideron se janë të nevojshëm për kryerjen e përgjegjësive të tyre.

38.2 Numri i anëtarëve të secilit komitet duhet të përcaktohet nga Kuvendi i komunës.

38.3 Kryetari i komunës i propozon Kuvendit të komunës anëtarët e komiteteve, që nuk janë anëtar të Kuvendit të komunës.

38.4 Kuvendi i Komunës në baze të nenit 51 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale formon këto komitete të përhershme dhe konsultative

Neni 39

39.1 Komitetet e përhershme janë: Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete. Numri i anëtarëve dhe përbërja e komiteteve përcaktohet me vendim të Kuvendit të komunës,

39.2 Komitetet konsultative janë: Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Arsim dhe Kulturë, Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Emergjencë dhe Shërbime Publike dhe komiteti për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari. Kuvendi i komunës mund të formojë edhe komitete tjera sipas nevojës.

39.3 Komitetet konsultative themelohen nga Kuvendi i komunës pas propozimit të marrë nga kryetari i komunës, nga komitetet e përhershme dhe nga shoqëria civile. Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve në komitete konsultative rregullohet me vendim të kuvendit të komunës.

Neni 40

Në takimet e tyre të para në secilin vit fiskal, Kuvendi komunal dhe secili komitet, duhet të aprovojë planin e punës ku do të parashihet edhe orari i takimeve të rregullta. Data e mbajtjes së mbledhjeve mund të ndryshohet me vendim pasues, mbledhjet tjera mund të thirren në çdo kohë.

Neni 41

Të gjitha mbledhjet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës. Personi i cili thërret apo udhëheq mbledhjen duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje, kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha veprimet.

42.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të Kuvendit komunës janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara që është objekt diskutimi përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

42.2 Kuvendi i komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme, ndër të tjera me mjetet e më poshtme të informimit.

- a) Shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
- b) Mediat e shkruara dhe elektronike lokale dhe
- c) Faqen e internetit të Kuvendit të komunës etj,

42.3 Njoftimet publike duhet të përmbajnë: datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes, dhe rendin e punës.

42.4 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes. Njoftimet publike përmbajnë: datën e mbledhjes, kohën e mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e punës.

Neni 43

Çdo pjesëmarrës në mbledhjet e Kuvendit komunal dhe komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të mbledhjes mund të bëjë pyetje dhe mund ti drejtohet mbledhjes. Rregullorja e punës mund të rregullojë të drejtat dhe veprimet e udhëheqësit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Neni 44

44.1 Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të emërohen nga radhët e anëtarëve të kuvendit komunës. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimit gjinor në kuvendin e komunës.

44.2 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk mund të jenë edhe anëtar të komiteteve tjera.

44.3 Numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë së paku 5 dhe më së shumti 9 anëtarë.

44.4 Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, kryesohen nga Kryesuesi i kuvendit. Në mungesë të Kryesuesit të kuvendit mbledhja kryesohet nga një anëtarë i komitetit

Neni 45

45.1 Anëtarët e Komitetit për Komunitete emërohen nga Kuvendi i komunës nga radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve. Shumica e anëtarëve të këtij komiteti duhet të jenë anëtarë të Kuvendit komunal.

më së shumti 7 anëtarë.

45.3 Emërimi i anëtarëve jashtë Kuvendit të komunës duhet të bëhet duke respektuar përvojën adekuate dhe kriteret profesionale, me një përfaqësim sa më të gjerë .

Neni 46

Detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të përhershme do të përcaktohen në Rregulloren e Punës së Kuvendit . Një përcaktim i detyrave dhe përgjegjësiave në Rregulloren e Punës së Kuvendit do të bëhet edhe për komitetet konsultative.

Neni 47

Kuvendi i komunës përveç komiteteve të përhershme dhe atyre konsultative mund të formojë edhe komitete tjera të përkohshme, përbërja e të cilave do të jetë me përfaqësim të anëtarëve të Kuvendit dhe jashtë tij.

Kuvendi i komunës me vendim të veçantë do të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre komiteteve.

KAPITULLI IV

INFORMIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 48

48.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit komunal të përcaktuar në nenin 39 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale mundë të adresohen me shkrim tek kryetari i komunës ,i cili në afat prej 15 ditësh duhet ti përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të Kuvendit të komunës..

48.2 Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga zyrtari përgjegjës i komunës, i cili duhet të shënuar datën e kërkesës së marrë dhe datën e përgjigjes së dhënë.

48.3 Në qoftë se kryetari i komunës konsideron se dhënia e ndonjë përgjigje për kërkesën apo pyetjen e veçantë është e dëmshme për interes e përbashkëta të qytetarëve të komunës, ai mundë të refuzojë me shkrim duke paraqitur arsyet për dhënien e përgjigjes së tillë.

KAPITULLI I V

KOMPENZIMI I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 49

Kuvendi i komunës duhet t'i kompensojë anëtarët e Kuvendit dhe të komiteteve të tija. Kompensimi për anëtarët e Kuvendit të komunës dhe anëtarët e komiteteve nuk mund ti tejkalojnë rregullat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

49.2 Mënyra dhe procedura do të rregullohet me vendim të veçantë të Kuvendit të komunës.

KAPITULLI VI

KONFLIKTI I INTERESIT I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 50

Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të kuvendit të komunës.

Neni 53

Anëtari i Kuvendit të komunës, i komiteteve të tij apo i cilit do organ vendimmarrës nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilën do çështje në të cilën ai apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ka interes personal apo material.

Neni 54

Çdo anëtar i Kuvendit, i komiteteve apo organeve vendim-marrëse, duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdo njëri prej mbledhjeve në të cilën është i pranishëm, në bazë të nenit 37 dhe 38 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 55

Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar nuk duhet të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt interesi dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes atëherë kur diskutohet ajo çështje.

56.1 Nëse vjen deri te ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të implimentohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

56.2 Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet dhe duhet të bëhet një votim i ri.

KAPITULLI I VII

MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE DHE PARTNERITETET

Neni 57

Kryetari i komunës, pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet t'i prezantojë rekomandimet Kuvendit komunal, për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Marrëveshjet ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisive dhe pushtetit bëhen në bashkëpunim me njëra tjetrën.

Neni 58

Kryetari i komunës pas konsultimit me Komitetin për Politikë dhe Financa paraqet rekomandimet e tij tek Kuvendi i komunës, në lidhje me marrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale për mbyqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike lokale që ofrohen në më shumë se një komunë.

Neni 59

Kuvendi i komunës në kuadër të kornizës ligjore, mund të bëjë marrëveshje, të bashkëpunojë dhe të formojë partneritete me Kuvendet tjera komunale ashtu që të realizojnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

Neni 60

Kuvendi i komunës mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione për mbrojtjen edhe promovimin e interesave të përbashkët.

KAPITULLI VIII

FINANCAT KOMUNALE DHE PROCEDURAT BUXHETORE

61.1 Komuna ka buxhetin dhe financat e veta për të ushtruar kompetencat e veta. Buxheti dhe Financat lokale rregullohen me ligjin për financat lokale dhe aktet tjera.

61.2 Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të komunës, janë përgjegjësi e Kryetarit të komunës të cilat përgjegjësi edhe mund ti bartë tek Nënkryetari i komunës dhe tek Drejtori i Drejtorisë për Financa Ekonomi dhe Zhvillim. Përjashtim nga këto çështje bëjnë ato që janë të rezervuara për Kuvendin e komunës.

Neni 62

Drejtorët e drejtorive komunale obligohen që ta njoftojnë Kryetarin për çdo veprim që është në kundërshtim me procedurat buxhetore, rregulloret fiskale; rregullat e prokurimit apo statutin e komunës.

Neni 63

Drejtorët e Drejtorive të komunës do të mbajnë kontrollin financiar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informatave financiare dhe sistemeve funksionuese, brenda drejtorive të tyre si dhe duhet t'ia japin informatat drejtorit të financave, ekonomisë dhe zhvillimit, dhe Auditorit të Brendshëm.

Neni 64

Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillimi do t'i japë këshilla financiare Kryetarit, Kuvendit të komunës dhe Komiteteve të tij si dhe drejtorëve të drejtorive , përfshirë këtu edhe vlerësimin financiar të rregulloreve, vendimeve dhe politikave financiare që shqyrtohen nga këto organe të komunës.

Neni 65

Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillimi do të paraqesë procedura, rregullore dhe rregulla financiare që do të jenë në përputhshmëri me procedurat, rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për të promovuar një administrim të fortë financiar brenda komunës dhe nga personeli i komunës.

Neni 66

Përcaktimi i të gjitha tatimeve, tarifave dhe pagesave si dhe ndryshimi i tyre duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 67

Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të procesit buxhetor, duke përfshirë edhe përgatitjen e tij dhe ciklin e konsultimit të brendshëm dhe konsultimit me publikun.

68.1 Konsultimet me publikun duhet të mbahen në kohën ndërmjet mesit të muajit Prilli dhe mesit të muajit Qershor në mënyrë që tu mundësohet të gjithë qytetarëve brenda komunës që ti japin mendimet e tyre për të hyrat dhe propozimet për investime të buxhetit.

68.2 Takimet konsultative ku përfshihen të gjitha pjesët e komunës duhet të lajmërohen nëpërmjet mediave lokale, një javë para mbajtjes së tyre dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa, dhe Zhvillimi duhet të sigurojë që të gjitha propozimet për investime në infrastrukturën sociale janë evidentuar.

68.3 Propozimet duhet t'i dërgohen Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të komunës së bashku me vlerësimin objektiv të drejtorit për vlerësimin e çmimeve dhe prioritetëve.

68.4 Konsultimet e buxhetit gjithashtu përfshijnë edhe informimin e qytetarëve për potencialin e të hyrave komunale duke përfshirë edhe tatimin në pronë dhe masën në të cilën këto të hyra do të mblidhen .

KAPITULLI IX

RAPORTI VJETOR

Neni 69

Kryetari i Komunës në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet të sigurohet që raporti vjetor t'i paraqitet Kuvendit të komunës pas përfundimit të çdo viti fiskal në komunë. Raporti i prezantohet kuvendit komunal për miratim jo më vonë se më 30 maj të vitit vijues.

Neni 70

Për të përmbushur përgjegjësitë për raportim të Kryetarit të komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të ndërmerren këto veprime.

1. Buxheti i komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive në pajtim me ligjin mbi financat lokale.

2. Objektivat duhet të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme,

3. Kryetari i komunës duhet të ndërtojë mekanizma përmes të cilëve monitorohet arritja e objektivave.

4. Të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme dhe të përcaktohen mjetet përmes të cilave sigurohet përmbushja e tyre.

Neni 71

Kryetari i Komunës së Kaçanikut zgjidhet me mandat katër vjeçar të njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal .

Neni 72

Kryetari i komunës është udhëheqës i degës ekzekutive të komunës dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejtë vote sipas ligjit mbi zgjedhjet lokale.

Neni 73

Kryetari i komunës ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale , statutin e komunës dhe rregulloren e punës së kuvendit, si në vijim :

- 1) Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbykqyrë administrimin financiar të komunës.
- 2 Mbykqyrë zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës:
- 3 Deleton përgjegjësit tek nënkryetari dhe anëtarët e ekzekutivit dhe mbikyrë zbatimin e përgjegjësive të deleguara;
- 4 I propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e drejtorive dhe funksionin e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- 5 I ofron propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve;
- 6 Bënë caktimin apo ndarjen apo koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të drejtorive sipas nevojës duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar.
7. Emëron dhe shkarkon nënkryetarin dhe drejtorët e Drejtorive, dhe kryeson mbledhjet e ekzekutivit të komunës.
8. I propozon Kuvendit të komunë zhvillimin, planin rregullativ dhe investues si dhe propozim-buxhetin dhe pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës është përgjegjës për zbatimin e tij.
- 9) Raporton në Kuvendin e Komunës së paku një herë në gjashtë muaj apo çdoherë që kërkohet nga ai, ose së paku prej një të tretës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
- 10 Mund të kërkoj që Kuvendi i Komunës ta shqyrtoj një akt komunal para hyrjes në fuqi kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim apo interesin e komuniteteve;

Neni 74

Ekzekutivi i komunës – Kryetari, për të ushtruar përgjegjësit e përcaktuara me ligj ndihmohet nga nënkryetari dhe drejtoritë komunale.

Neni 75

Mandati i kryetarit të komunës mund të përfundoj vetëm sipas mënyrës së përcaktuar me ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit mbi Zgjedhjet Lokale.

NËNKRYETARI I KOMUNËS

Neni 76

76.1 Nënkyetari i komunës emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari

76.2 Nënkyetari e ndihmon kryetarin në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij.

KAPITULLI II

DREJTORITË KOMUNALE

Neni 77

Administrata komunale organizohet në drejtoritë, çdo drejtori menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari.

Administrata komunale organizohet përmes këtyre drejtorive.

- a) Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme
- b) Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- c) Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës,
- d.) Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit,
- e.) Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- f.) Drejtorinë e Emergjencës dhe Shërbime Publike dhe
- g) Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

Drejtoria e Administratës përgjithshme

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- a) Kujdeset për funksionimin e administratës komunale përfshirë shërbimin e kuvendit dhe të ekzekutivit të komunës.
- b) Mbikëqyrë sektorin e Ofiqarisë dhe gjitha shërbimet që kryen ky sektor në pajtim me ligjin e Kuvendit të Republikës së Kosovës që rregullon këtë sektor
- c) Kujdeset për funksionimin e Zyrës Pritëse dhe Arkivin e komunës,
- d) Kujdeset për funksionimin e shërbimeve logjistike duke përfshirë transportin, depon, postën, inventarin, shërbimin e sigurimit, përkthimin e dokumenteve zyrtare, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative dhe mirëmbajtjen e objekteve,
- e) Është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe transparencën e shërbimit civil komunal, mirëmbajtjen e Web faqes komunale si dhe freskimin e saj ,
- f) Është përgjegjëse për sigurimin e transparencës dhe respektimin e të drejtave të njeriut,
- g) Ofrimin e bashkëpunimit, këshillave dhe ndihmës profesionale drejtorive tjera mbi të gjitha çështjet administrative,
- h) Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

Neni 79

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- a) Ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor në komunë, në pajtim me dispozitat ligjore.
- b) Inspektimin e qendrave private të përkujdesit primar shëndetësor,
- c) Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare,
- d) Vendosjen e objektivave lokale për kujdesin primarë shëndetësor,
- e) Hartimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH.
- f) Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF, QMF dhe Ambulancave.
- g) Operimin (bashkëpunimin) e qendrave për punës sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale.
- h) Zhvillimin e planit strehimor për territorin e komunës,
- i) Sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të përcaktuara nga MPSP.
- 2) Ndërmerr masat mbrojtëse shëndetësore,
- dh) Punë tjera të caktuara nga Kryetari, dhe ligjet në fuqi

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- a) Planifikon zhvillimin e arsimit lokal dhe aftësimin e personelit mësimor në bashkëpunim të ngushtë me MASHT,
- b) Nxist bashkëpunimin midis personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit,
- c) Siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse me fondet publike të siguruara,
- d) Do të bëjë organizimin dhe mirëvajtjen e procesit arsimor në nivel parashkollor, fillor dhe të mesëm, 0,1, 2, dhe 3
- e) Nxjerr rregulla disiplinore për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në çdo institucion arsimor,
- f) Merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe mësuesve të shkollave,
- g) Menaxhon në mënyrë të drejtë me të gjitha objektet komunale të kulturës, sportit dhe rinisë.
- h) Organizon takimet me rëndësi kulturore, sportive dhe të rinisë për komunën,
- i) Organizon debate për zhvillimin e kulturës , sportit dhe rinisë në komunë,
- j) Kujdeset për të arritura kulturore, sportive dhe rinore në komunë dhe mban evidencën mbi këto të arritura.
- k) Zhvillon planin për mbështetjen e aktiviteteve kulturore sportive dhe rinore,
- l) Kryen punët tjera të përcaktuara nga ligjet përkatëse dhe të caktuara nga Kryetari i Komunës.

Neni 81

Drejtoria Për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim

Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) Hartimin e rregulloreve komunale për çështje financiare,
- b) Ndihmon Kryetarin e Komunës në përgatitjen e buxhetit,
- c) Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare vjetore,
- d) Është përgjegjës për menaxhimin e thesarit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës,
- e) Është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit,
- f) Përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit, i kryen të gjitha pagesat pas aprovimit nga Kryetari i Komunës dhe drejtorja përkatëse.
- g) Jep këshilla profesionale nga fusha e buxhetit organeve komunale,
- h) Harton plane për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës,

- j) Harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda komunës,
- k) Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,

l) Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

Neni 82

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- a) Hartimin e planit zhvillimor të komunës,
- b) Hartimin e planit të zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të komunës,
- c) Harton kriteret për dhënien e lejeve të ndërtimit,
- d) Harton kriteret për dhënien me qira të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të komunës,
- e) Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të komunës,
 - f) Bënë vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi.
 - g) Mban regjistrin e pronës së paluajtshme dhe regjistrin e tokës komunale,
 - h) Bënë azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara.
 - i) Mbron pronën komunale nga uzurpimet e ndryshme,
 - j) Harton rregullore lokale për kontrollimin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të komunës,
 - k) Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit,
 - l) Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

Neni 83

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

- a) Është përgjegjëse për transportin lokal në komunë dhe bashkëpunimin ndër komunal.
- b) Mbikëqyrë dhe bashkëpunon me kompanitë shërbyese komunale të higjienës dhe furnizimit me ujë.
- c) Harton planin lokal për administrimin e mbeturinave,
- d) Mbikëqyrë procedurën e pastrimit të ujërave dhe sipërfaqeve publike,
- e) Bën menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha shesheve publike që i përkasin komunës si dhe përkujdesjen për mirëmbajtjen e varrezave.
- f) Kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve lokale,

mbrojtëse nga zjarri.

i) Organizon punën me organet e sigurisë në Komunë në bashkëpunim me SHPK-ën, FMK dhe organet e sigurisë ndërkombëtare.

j) Bashkëpunon me institucionet, organizatat joqeveritare dhe të gjithë mekanizmat tjerë në raste të fatkeqësi elementare.

k) Në raste të jashtëzakonshme i propozon Kryetarit të komunës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme si dhe propozon urdhëresa dhe masa tjera administrative,

l) Krijdeset për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta

m) Kryen dhe detyra tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

Neni 84

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

a) Mbrojtjen e tokës bujqësore,

b) Mbrojtjen e evidencës për tokën bujqësore dhe evidencën e tokës së cilës është ndërruar destinimi,

c) Të bashkëpunojë me bankat komerciale, të hulumtoj format e kreditit për stimulimin dhe avancimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

d) Të ofrojë shërbime veterinarë dhe të përkujdesjes për mbrojtjen e shëndetit dhe paraandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake.

e) Mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, rëën, dhe aktivitetet për llogjen e gurorëve.

f) Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryetari dhe të përcaktuara me ligj.

PJESA E VII

SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Neni 85

Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit në shërbimin civil të komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbëues civilë të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 86

87.1 Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit i cili rekrutohet nga kryetari i komunës në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 90

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave statutare me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, do të mbizotërojnë dispozitat e ligjit..

Neni 91

Ky statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimin të tij nga Kryesuesi i Kuvendit .

Neni 92

Pas hyrjes në fuqi të këtij statuti pushojnë të vlejnjë të gjitha dispozitat dhe aktet komunale të mëparshme në ato pjesë ku janë në kundërshtim me statutin e komunës.


Neni 93

Me aprovimin e këtij statuti të gjitha aktet tjera të komunës do të harmonizohen me statutin në fuqi

Neni 94

Interpretimi autentik i këtij statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës

25 Shtator 2008



Kryesuesi i Kuvendit